

VENDIM
Nr.372, datë 27.3.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.49, DATË 27.11.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIZIMIN, VARËSINË
STRUKTURORE DHE LIMITIN ORGANIK TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet vendimit nr.49, datë 27.1.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

“Oficeri shoqërues, në përbërjen organike të grupit të shoqërimit të Kryetarit të Kuvendit, nga “niveli i mesëm” bëhet “niveli i lartë”.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha